

20252044072

Bazuar në nenin 22 paragrafin (22) të Ligjit për Arsimin e të Rriturve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" Nr. 3/25), Ministri i Arsimit dhe Shkencës, solli

**RREGULLORE PËR MËNYRËN E VERIFIKIMIT TË PROGRAMIT TË VEÇANTË
PËR ARSIMIN E TË RRITURVE, SI DHE FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E
FORMULARIT TË KËRKESËS PËR VERIFIKIMIN E PROGRAMIT TË VEÇANTË
DHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e verifikimit të programit të veçantë për arsimimin e të rriturve (në tekstin e mëtejshëm: programi i veçantë), si dhe forma dhe përmbajtja e formularit të kërkesës për verifikimin e programit të veçantë dhe dokumentacionin e nevojshëm.

Neni 2

Nga ana e entit apo institucionit për arsimin e të rriturve (në tekstin e mëtejshëm: ofruesi i shërbimeve), i cili dëshiron të realizojë program të veçantë, dorëzohet kërkesë për verifikimin e programit të veçantë me dokumentacionin e nevojshëm në Qendrën për Arsimin e të Rriturve (në tekstin e mëtejshëm: Qendra), dhe atë:

- dokument për veprimtari të regjistruar – arsim për të rritur, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut,
- programi i veçantë në tre ekzemplar dhe
- fletëpagesë për pagesën e kompensimit të bërë për verifikimin e programit të veçantë në llogarinë e Qendrës, sipas vendimit për kompensimin e verifikimit të programit të veçantë për arsimin e të rriturve.

Neni 3

(1) Kërkesa për verifikimin e programit të veçantë dorëzohet veçmas për secilin program të veçantë, në formular me përmasa 21 cm x 29,7 cm.

(2) Forma dhe përmbajtja e formularit të kërkesës për verifikimin e programit të veçantë janë të dhëna në Shtojcën, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

Neni 4

(1) Pas dorëzimit të kërkesës për verifikimin e programit të veçantë dhe dokumentacionit të nevojshëm, Komisioni për verifikimin e programit të veçantë për arsimin e të rriturve (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni), e shqyrton dokumentacionin dhe programin e veçantë të dorëzuar dhe e realizon evaluimin e tij.

(2) Nga ana e Komisionit, drejtorit të Qendrës i dorëzohet procesverbal, me të cilin propozon zgjidhje në lidhje me kërkesën për verifikimin e programit të veçantë, me të cilin mund:

- të pranojë kërkesën dhe programin e veçantë të dorëzuar, ose
- të refuzojë kërkesën dhe programin e veçantë të dorëzuar.

(3) Nëse Komisioni konstaton se ka mangësi në programin e veçantë të dorëzuar, i dorëzon procesverbal drejtorit të Qendrës.

(4) Nga ana e drejtorit, ofruesi i shërbimeve njoftohet me shkrim që të bëjë ndryshime dhe plotësime në programin e veçantë, në përputhje me shënimet e dhëna në procesverbal.

(5) Programi i veçantë i korrigjuar duhet të dorëzohet nga ofruesi i shërbimeve më së voni dhjetë ditë nga dita e pranimit të njoftimit për korrigjimin e programit, në Qendër.

(6) Nëse programi i veçantë i korrigjuar nuk dorëzohet brenda afatit të përcaktuar në paragrafin (5) të këtij neni, kërkesa nga paragrafi (2) i këtij neni dhe programi i veçantë i dorëzuar refuzohen.

Neni 5

(1) Pas shqyrtimit të programit të veçantë të ndryshuar dhe të plotësuar nga ana e Komisionit, dorëzohet procesverbal nga vlerësimi i kryer i programit të veçantë dhe mendim i jepet Drejtorit të Qendrës.

(2) Nëse, pas shqyrtimit të programit të veçantë të korrigjuar, Komisioni përcakton se vërejtjet në procesverbal nuk janë trajtuar siç duhet, ai i dorëzon procesverbal drejtorit dhe i propozon zgjidhje për të refuzuar plotësisht kërkesën për verifikim të programit të veçantë dhe programit të dorëzuar

Neni 6

Ofruesit të shërbimeve, kërkesa për verifikimin e programit të veçantë e të cilit është refuzuar nga Qendra, i dorëzohet arsyetim me shkrim për arsyet e refuzimit të kërkesës për verifikimin e programit të veçantë dhe të programit të dorëzuar.

Neni 7

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e ardhshme nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 18-12743/3

1.10.2025

Shkup

Ministre e Arsimit

dhe Shkencës,

Pr.Dr. **Весна Јаневска**, d.v.

Shtojcë

Për IP Qendra për Arsimin e të Rriturve – Shkup

K Ë R K E S Ë
PËR VERIFIKIMIN E PROGRAMIT TË VEÇANTË PËR ARSIMIN E TË RRITURVE

Të dhëna për programin e veçantë	
Emri i programit të arsimit të të rriturve	
Sektori	
Standard(e) të lidhura të profesioneve / kualifikimeve	
Të dhëna për institucionin / entin për arsimin e të rriturve	
Emri i institucionit / entit për arsimin e të rriturve	
Numri i regjistrimit të institucionit / entit	
Administratori / personi i autorizuar	
Adresa	
Numri i telefonit	
Adresa e e-mailit:	
Veprimtaria e institucionit / entit	
Unë, i nënshkruari më poshtë, vërtetoj se:	
Programi i veçantë që po dorëzoj çon në përvetësimin e:	
☐ kualifikime profesionale ose pjesë e kualifikimeve profesionale ☐ njohuri, aftësi dhe kompetenca që nuk janë pjesë e kualifikimit profesional	
2. Në bashkëngjitje me kërkesën dorëzoj dokumentacionin e mëposhtëm: - dokumenti për veprimtari të regjistruar – arsim për të rritur, i lëshuar nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, - programi i veçantë në tre ekzemplar, dhe - fletëpagesë për pagesën e kompensimit për verifikimin e programit të veçantë në llogarinë e Qendrës, në përputhje me vendimin për kompensim për verifikimin e programit të veçantë të arsimit për të rritur	

Data:

Kërkuesi:

3

(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi i administratorit/ /personit të autorizuar)
 (Vula e entit ose institucionit)